



Pranimi / Prizetimi Position / Prizetimi Receipt of the Party	13. 01	2022	2	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	SKRIMSHEK	128/2022	Shtesa Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
				119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.969/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.969/2021 të datës 30.11.2021 të parashtruar nga ankuesi

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministrisë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.969/2021 e datës 30.11.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. OBLIGOHET Njësia e Burimeve Njerëzore që t’ia njihë ankuesit të drejtën në pushim prej tre (3) ditësh si kompensim për punën e kryer gjatë ditëve të vikendit (datë 23 dhe 24 tetor 2021).

III. OBLIGOHET Sekretari i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me kërkesë të Avokaturës Shtetërore nga data 23 deri me datë 28.10.2021 ka realizuar vizitë zyrtare jashtë vendi me qëllim të përgatitjes së seancës në Arbitrazh në Pragë të republikës Çeke.

Ankuesi pas kthimit nga vizita zyrtare jashtë vendi me datë 18.11.2021 përmes e-maili i është drejtuar Udhëheqëses së Personelit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me kërkesën për kompensimin e dy (2) ditëve të punës jashtë orarit për datën 23 dhe 24 tetor 2021 me tre (3) ditë pushim sipas Rregullosës Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimeve të Zyrtarëve Publikë, ndërsa Udhëheqësja e

Personelit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me datë 25.11.2021 e ka udhëzuar ankuesin që të drejtën e ankimit ta realizojë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 50102/21 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 07.12.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 16.12.2021 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5702/2021 të datës 30.11.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari orë e punës jashtë orari i datës 04.11.2021; Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare; Vendimin me numër: 01/1214 e datës 20.06.2018 të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës i datës 20.06.2018; tabela për tarifën e shpenzimeve për udhëtimet e zyrtarit jashtë vendit i vitit 2018; E-mailin e datës 25.11.2021 dërguar nga [] për ankuesin; E-mailin e datës 24.11.2021 dërguar nga ankuesi për [] E-mailin e datës 18.11.2021 dërguar nga ankuesi për []; E-mailin e datës 28.11.2021 dërguar nga [] për [] me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; kërkesën e ankuesit realizuar përmes e-mailit të datës 18.11.2021 dërguar [] Formulari/llogaritës për udhëtime zyrtare; Kërkesa për udhëtim zyrtar i datës 12.10.2021; Raporti për udhëtimin zyrtar; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 07.12.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 16.12.2021; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të emërimit i datës 14.02.2013; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Shkresën e datës 06.10.2021 të Ambasadës së Republikës Çeke në Shkup; E-mailin e datës 15.12.2021 dërguar nga ankuesi për [], E-mailin e ankuesit të datës 15.12.2021 dërguar nga ankuesi për [] i orës 11:26 AM me korrespondencën e bashkangjitur; Formulari/llogaritës për udhëtime zyrtare i aprovuar i datës 13.12.2021; Urdhër për pagesë i datës 07.12.2021; Tabelën e arsytimit për shpenzimet zyrtare; Marrëveshje për pagesë të avancit e datës 07.12.2021; E-mailin e datës 11.10.2021 dërguar nga [] për [] dhe të tjerët; E-mailin e datës 12.11.2021 dërguar nga ankuesi për [] E-mailin e datës 11.11.2021 dërguar nga [] për [] me korrespondencën e bashkangjitur; Flete tërheqja e datës 08.12.2021; Forma për tërheqjen e parave të gatshme; Forma për kthim avanci; Fletë deponimi i datës 14.12.2021;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [] është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi së bashku me përfaqësuesit e Avokaturës Shtetërore ka qenë në vizitë zyrtare jashtë vendin përgjatë datave prej 23 deri me 28 tetor 2021 me qëllim të përgatitjes për seancën e Arbitrazhit në Pragë të Republikës Çeke ku Republika e Kosovës ka qenë në cilësinë e palës së interesit.

Ankuesi, datë 18.11.2021 përmes e-maili i është drejtuar Udhëheqëses së Personelit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me kërkesën për kompensimin e dy (2) ditëve të punës për datën 23 dhe 24 tetor 2021 me tre (3) ditë pushim sipas Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimeve të Zyrtarëve Publikë, ndërsa 18.11.2021 Udhëheqësja e Personelit i është drejtuar Drejtorit të Departamentit Ligjor me qëllim të kërimit të opinionit ligjor lidhur me kërkesën e ankuesit. Drejtorit i Departamentit Ligjor me datë 18.11.2021 i ka kthyer përgjigjen Udhëheqëses së Personelit se Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare nuk përcakton formë tjetër të kompensimit për punë jashtë orari gjatë udhëtimeve zyrtare përveç mëditjeve dhe shpenzimeve tjera gjatë udhëtimeve zyrtare.



Me qëllim të vlerësimit të drejtës të ligjshmërisë së ankesës së ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare, Vendimin e Ministrisë së Financave të datës Vendimin me numër: 01/1214 e datës 20.06.2018 të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës i datës 20.06.2018 si dhe Tabelën e Tarifave për Shpenzimet e Udhëtimit Zyrtar Jashtë Vendi dhe mbi këtë bazë vlerëson se nëse depozitat e lartcekura analizohen në mënyrë komulative lënë të kuptohet se të njëjtat rregullojnë apo përcaktojnë kompensimin e shpenzimeve financiare të krijuara me qëllim të realizimit të detyrës përkatëse për të cilën realizohet vizita dhe se zyrtari apo nëpunësi civil në rastin konkret këtë pagesë nuk e merr për punën e kryer sipas detyrës zyrtare ngase kjo çështje është e rregulluar me përshkrimin e detyrave të punës dhe akt emërimit përkatës ku për të cilën e ka garantuar edhe pagën sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se datat 23-24 tetor 2021 rezultojnë të jenë ditë vikendi (e shtune dhe e diele), ndërsa dispozitat e Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimeve të Zyrtarëve Publikë neni 4 paragrafi 1, neni 7 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.5 përcaktojnë: *“Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten; Në raste të veçanta, për shkak të rritjes së vëllimit të punëve apo nevojave emergjente, zyrtari publik mund të punojë jashtë orarit, apo të caktohet kujdestar, të punojë gjatë natës, gjatë festave zyrtare, apo gjatë fundjavës; Puna jashtë orarit kompensohet në masën pesëdhjetë për qind (50%) me kohë pushimi ose në masën pesëdhjetë për qind (50%) me shtesë page e llogaritur si më poshtë: 50 % shtesë në orë për orë pune gjatë fundjavës”*, andaj në kuptim të nenit 1 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 dhe 1.2 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *“Kjo Rregullore përcakton rregullat për: 1.1. kriteret dhe kushtet e orarit të punës, dhe 1.2. pushimet dhe procedurat për shfrytëzimin e pushimeve”*, si dhe nenit 25 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës”*, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ankuesi gjatë vizitës për punë zyrtare të realizuar në Pragë të Republikës Çeke përgjatë datave prej 23-28 tetor 2021 më qëllim të përgatitjes së seancës së Arbitrazhit ka mbrojtur interesat Shtetërore të Republikës së Kosovës sipas detyrës zyrtare, ndërsa meqenëse data 23 dhe 24 tetor rezulton të jetë ditë vikendi dhe duhet të vlerësohet si punë jashtë orarit, ankuesit duhet t’i njihet e drejta për kompensim në tre (3) ditë pushimi siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimeve të Zyrtarëve Publikë paragrafi neni 7 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.5, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore obligohet t’ia aprovojë kërkesën.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.969/2021

Flakron GASHI



Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

